

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës B. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.1132/16 të dt.21.04.2017, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **20.09.2017**, në prani të Prokurorit së shtetit Mone Syla si dhe të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara B. B. nga fsh. G. K Pejë, tani me banim në Gjakovë, e bija e I. dhe i nënës R. e gjinisë V.data e lindjes..., analfabete, e pa punë ,e gjendjes së varfër ekonomike- gjendje sociale, romë, shtetase e R. Kosovës, e martuar nënë e 2 fëmijëve, me nr. ID...,

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- Nga data e pavërtetuar e gjere me dt. 06.10.2015 ,në shtëpinë e saj në Gjakovë, rrugën “D. ” me qëllim që të sjell vetit pasuri në mënyrë të kundërligjshme në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 të Ligjit për Energji Elektrike të R. Kosovës,ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e zyrtareve të KEDS-it ,është konstatuar se e pandehura jashtë njehsorit elektrik me nr. 47558042,përmes kabllos 3x2.5 është lidhur direkt në rrjetin elektrik, duke pamundësuar kështu regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar ,më ç ‘rast të ndërmarrjes së dëmtuarës KEDS Divizioni në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 90.42 euro .

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73, dhe nenit 320 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, të akuzuarës i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2(dy) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100(njëqind)Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-Divizioni i rrjetit Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.1132/16 të datës 21.04 .2017 ,kundër të akuzuarës B. B. nga Gjakova , për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës, dhe ka propozuar që të akuzuarin të shpallë fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

E akuzuara B. B., gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar ,lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjë e tillë është konstatuar nga ana e KEDS-it ne shtëpinë te cilën e kam shfrytëzuar me qira ,e te cilën gjendje e kemi gjetur ne atë mënyrë pasi qe ajo shtëpi është e braktisur gjegjësisht vazhdimisht ka pasur njerëz qe e kanë shfrytëzuar me qira apo pa qira e te cilën tani nuk jam duke e shfrytëzuar qe 2 vite ,andaj gjykatës i propozojë qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,gjendjen e varfër ekonomike –me ndihma sociale, me qene se jetojmë ne familje prej 7 anëtarëve ku asnjeri nga anëtarët e familjes nuk punon dhe realizojmë ndihma sociale ne shume prej 62 euro, te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë prokurori i shtetit deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga e akuzuara pasi qe e njëjta është e vetëdijshme për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova te mjaftueshme .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara B. B., nga data e pavërtetuar e gjere me dt. 06.10.2015 ,ne shtëpinë e saj ne Gjakovë, rrugën “D.” me qellim qe ti sjell vetit pasuri ne mënyrë te kundërligjshme në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 te Ligjit për Energji Elektrike të R. Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike ne atë mënyre qe gjate kontrollit nga ana e zyrtareve te KEDS-it ,është konstatuar se e pandehura jashtë njehsorit elektrik me nr. 47558042, përmes kabllor 3x2.5 është lidhur direkt ne rrjetin elektrik, duke pamundësuar kështu regjistrimin e saktë te energjisë elektrike te shpenzuar, më ç ‘rast te ndërmerret se dëmtuarës KEDS Divizioni ne Gjakovë i ka shkaktuar dem ne vlere prej 90.42 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpall fajtores dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës , gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës: si pranimin e fajësisë, pendimin e saj dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, gjendjen e saj të dobët ekonomike-shfrytëzuese e ndihmave sociale ,sjelljen korrekte në gjykatë ,personalitetin e saj nënë e 2 fëmijëve , është hera e parë qe ka ra ndesh me ligjin, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2(dy) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100 (njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPP-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri në mbështetje të nenit 453/4 të KPP-ës ,pasi që e akuzuara është shfrytëzuese e ndihmave sociale e detyrimi që ti paguajnë shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarës ose të personave që ajo detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.272/17 më datë 20.09.2017.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej **15 dite**, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.